



NJOFTIM PËR TË GJITHË KREDITORËT DHE PRONARËT E NDËRMARRJES

MIT113 - Ndërmarrja për mirëmbajtje ndërtimore Zevčan

Emrat alternativë/emrat e mëparshëm dhe numrat e regjistrimit:

Radna Organizacija "Gradjevinsko održavanje" Zvečan

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe nenit 7 të Shtojcës të këtij ligji, **NJOFTOHENI** se Likuidimi i Ndërmarrjes së lartpërmendur ka filluar me datë 2 tetor 2017 në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 21 dhe 25 shtator 2017.

Çdo person i cili pretendon se ka të drejtë kërkesë dhe/apo interesi ndaj kësaj ndërmarrjeje apo asetit të ndërmarrjes duhet të parashtojë Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit sipas nenit 7 dhe nenit 23 të Shtojcës të Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në.

Afati për parashtrimin e kërkesave kreditore fillon me datë 12 tetor 2017 dhe përfundon me datë 27 nëntor 2017 në orën 16:00.

Ftoheni që të parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit pavarësisht nëse më herët mund ta keni informuar Agjencinë Kosovare të Privatizimit apo pararendësin e saj. Nëse nuk parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit brenda afatit kohor të lartë cekur, pretendimet tuaja do të refuzohen si të papranueshme bazuar në nenin 35 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në. Mosdorëzimi i dokumentacionit në mbështetje të kërkesës tuaj apo mosplotësimi i rregullt i formularëve, gjithashtu do të rezultojë në refuzimin e pretendimeve tuaja.

Formularët për Dëshminë e Kërkesës si dhe Dëshminë e Interesit mund të merren në të gjitha zyrat e AKP-së dhe duhet të dorëzohen në Zyrën Rajonale të AKP-së çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në ora 14:00 në adresën si më poshtë.

**Agjencia Kosovare e Privatizimit
Zyra Rajonale në Mitrovicë
Mbretëresha Teutë, pn (afër Sallës së Sporteve),
Mitrovicë, 40 000
Telefoni: +381 28 534 690
Fax: +381 28 534 590**

Formularët për parashtrim të Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit gjithashtu mund të shkarkohen edhe nga faqja e internetit të AKP-së në adresën www.pak-ks.org. Për udhëzime se si të plotësohen dhe dorëzohen këta formularë referohuni tek seksioni "**Formularët-Udhëzime për plotësim**". Formularët e dorëzuar përmes postës elektronike nuk do të pranohen.